



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 09/11/2021

Proces-verbal

Në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon për hartimin e Paketës Fiskale dhe Buxhetit, datë 04.11.2021, me përfaqësuesin e Sindikatës Shqiptare të Taksive, dega Korçë, në lidhje me problematikat që ka sektori i transportit të udhëtarëve me taksi me kapacitet 4+1.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Korçë, Nikolin Lika Specialist për Shërbimin e Transportit, Bashkia Korçë, si dhe Niko Rusi kryetar i Sindikatës Shqiptare të Taksive, dega Korçë.

Në këtë takim u diskutua për evidentimin e sfidave për të ardhmen si dhe mundësinë për lehtësimin e ushtrimit të punës së tyre dhe përmirësimin e kushteve të transportit.

Gjatë takimit u evidentuan problematikat që shqetësojnë sektorin e transportit të udhëtarëve si dhe angazhimet e Bashkisë Korçë për lehtësi fiskale, për këtë sektor të transportit rrugor. Përsa i përket ndryshimeve për vitin 2022, nga ana e bashkisë referuar edhe problematikave të paraqitura gjatë vitit por edhe më përpara, po mendohet për lehtësimin e barrës fiskale për të gjitha taksitë 4+1. Kjo për vetë faktin se gjatë periudhës së pandemisë ky sektor edhe pse ka punuar, ka pasur kufizime në lëvizje. Edhe pse në dy vitet e fundit nuk ka pasur rritje të tarifave, bashkia është duke menduar për lehtësimin e barrës fiskale për vitin 2022.

Kryetari i Sindikatës Shqiptare të Taksive, dega Korçë përgjatë këtij takimi listoi kërkesat e tij si në vijim:

1. Sistemim i hapësirave ku do të vendosen taksitë e transportit të udhëtarëve 4+1, në zona të ndryshme të qytetit.
2. Diferencim për pajisjen me licensë të ushtrimit të profesionit, për ata drejtues mjetesh që sapo janë pajisur me leje drejtimi dhe nuk kanë kualifikimin e duhur.
3. Lëvizje të pakufizuar në qytete të tjera për të çuar udhëtarët, sepse shpesh përballemi me gjoba.
4. Kontrollë të vazhdueshme për të luftuar informalitetin, pasi ka shumë taksi që punojnë pa licensë.